

dhe jepini unazën në dorë, dhe këpuce për këmbët, edhe bjereni viçin e ushqyer, edhe thereni, që të hamë dhe të dëfrenjmë, se im-bir ish i vdekur dhe u-ngjall, ish i humbur dhe u-gjent.” Edhe nisë të dëfrenin. Dhe i-biri i math ishte në arën. Dhe kur po kethehej dhe afrohej në shtëpi, dëgjoj muzika dhe valle, dhe thirri një shërbëtor dhe e pyeti seç qenë gjithë ato. Edhe ay u-përgjiej: “Yt-vëlla ka ardhur, dhe yt-atë ka therur viçin e ushqyer, se e pa të shëndoshë.” Dhe ay u-zëmërua, dhe nukë deshte të hynte brënda. I-ati, pra, dolli dhe i lutej. Po ay u-përgjiej edhe i tha t’ atit: “Ja ku po punoj kaqë vjetë për ty, edhe kurrë nukë kam shkelur porrositë e tua, dhe nukë më ke dhënë kurrë nonjë kec, që të dëfrenj me miqtë e mi; po kur ardh i yt-bir, i cili ta ka ngrënë gjënë me lavirat, ia there viçin e ushqyer.” Dhe ay i tha: “Bir, ti je gjithënjë me mua, dhe të gjitha të miat janë të tuat. Po duhej të dëfrenja dhe të gëzohësha, se yt-vëlla ish i vdekur dhe u-ngjall, ish i humbur dhe u-gjent.”

Pastaj vazhdon Mesha e Shën Joan Gojartit.

E SHTUNA E SHPIRTEVE

Për këndimet shiko të Shtunën përpara Rushajeve.

E DIELA E TE LIDHURAVE

THIRRTORET

Këndohen dhjetë Tropare, domethënë shtatë të Tingëllit edhe dy të Përshëmbëllta të Triodit më T.T.II, dyke përsëritur të parën:

PAS OLIN APOTHEMENI

Prapë kur të vish mi dhe, të na gjykosh pas kanunit, o Gjykatës drejtësisht, edhe kur të rrish përmi fronin me lavdi, me një lumë flag' e zjarr, që po djek dhe përvëlton, të dënuarit për çdo mëkat, dyke patur Engjëjtë, reth me gjithë forcat e qjellshime, dhe dridhen gjithë njerëzit, çfaqen gjithë fajet e fshehura. Kij për ne mëshirë, vëndosna me të vyerit o Krisht, me shoqërin' e Shenjtorëve, ne që po të lutemi.

Librat hapen faqeza, edhe zbulohen të fshehtat, veprat e fajtorëve, gjithë të këqiat e mëkatarëve; fush' e tërë tej përtej, gumëzhit plot me tmerr, me vajtim edhe me psherëtim, se të dënuarit, hidhen në mundime që s' kanë funt, në zjarrin dhe në sqyfurin, dhe në kërcëllimin e dhëmbëve. Kij për ne mëshirë, vëndosna me të vyerit o Krisht, me shoqërin' e Shenjtorëve, ne që po të lutemi.

LAVDI, T.T.IV. Kur vëndosen fronet, edhe hapen librat, edhe Perëndia shtrohet për gjyqin, oh sa frikë e madhe ahëre! Engjëjtë qëndrojnë të trëmbur, dhe lumi i zjarrit përvëlton. Ç' do të bëjmë ahëre, ne njerëzit të mbytur në mëkata? Dhe kur ta dëgjojmë që i fton, të bekuarit në Mbretërinë e Atit, edhe të mallkuarit në Skëterrën e zezë, cili do ta duronjë vëndimin e tmerruar? Po ti o Shpëtimtar njeridashës, o Mbret i gjithë jetëve, përpara se të arrinjë fundi, kthe-më me anën e pendimit edhe mëshiro-më.

Tania e Tingëllit, edhe Pasvargjet e Tingëllit.

LAVDI, T.T.IV. Mjer' o shpirt i zi! Kur do të çkëputesh nga të këqiat? Gjer kur do të dergjesh në ngathësi? Përse nukë mejton orën e tmerruar të vdekjes? Përse nukë dridhesh përpara Tribunës së Krishtit?

Si do të mprohesh edhe si do të përgjigjesh? Veprat e tua çfaqen si prova. Mëkatat e tua të kallëzojnë dhe të dënojnë. Ngrehu o shpirti im, se koha arriu. Rent me vrap edhe thirr me besë: Bëra faj o Zot përpara teje, po e di që je njeridashës dhe mëshirëplot. O bari i mirë radhit-më nga ana e djathtë, dhe fal-më përdëllimin e math.

Tania e Tingëllit, edhe Përlëshoret e Tingëllit.

SHKURTORJA, T. I.

Kur vjen o Perëndi, me lavdi përmi dhenë, kur dridhen gjithë tok, dhe një lumë prej zjarri, përpara fronit tënt po rjeth, edhe librat e veprave, hapen faqeza, edhe të fshehtat botohen, ti shpëto-m' o Zot, dhe më vëndos më të djathtë, gjykatës me drejtësi.

SHTEPIA

Kur mejtohem për ditën e tmerruar të gjyqit, o Zot i zëmërdhëmpshur, dridhem i trëmbur prej ndër-gjegjes, e cila më kallëzon dhe më dënon. Kur të vëndosesh mi fronin, dhe të nisësh vëzhgimet, ahëre askush nukë do koxonjë t'i mohonjë mëkatat, se e vërteta do të dalë në shesh, dhe zjarri do t'i përvëltonjë mëkatarët. Mëshiro-më pra dhe shpëto-më o Zot, dhe më vëndos më të djathtë, gjykatës me drejtësi.

SINAKSARI

Gjithë sot, kujtojmë Ardhjen e Dytë të Zotit tonë Jesu Krisht.

Me njeridashjen e patreguar, o Krisht o Perëndi, vlerëso-më për ftimin e dëshëruar, dhe radhit-më nga ana e djathtë, dhe mëshiro-më. Amin.

ZBRITESORET, T.T.II.

VOITHOS KE SKEPASTIS

I. Ti më ndih ti më përkrah, ti më shpëton nga të gjith' armiqtë, ti je Zoti im, edhe ty të këndonj, Perëndi i Atit, dhe do të lartësonj, o Zot i Math lavdi më ty.

III. Ti më shiguro o Zot, me porrosit' e tua prej shkëmbi, zëmren time të tronditur keq, se ti je i vetëmi i Shenjtë o Perëndi.

IV. Dëgjoj Profeti i Shenjtë, që ti o Zot po vjen mi dhen' e ishte trëmbur, që do të lintnje prej Hyllindëses, edhe do të çfaqëshe nër njerëzit. Dëgjova thoshte lajmën tënde dhe jam trëmbur! Zoti i fuqishim ladvi më ty.

V. Pranë teje vijm' o Zot, që në mëngjes, ndritna të lutemi, edhe prirna gjithënjë në porrosit' e tua, edhe mësona të bëjmë dëshirën tënde.

VI. Me tërë zëmren e kam thirrur besërisht, të Madhin Zot mëshirëplot, dhe më ka dëgjuar prej Ferrit më të poshtme, dhe ma nxori prej gropës jetën e mjerë.

VII. U-mbytmë në mes të fajeve, dhe mëkatave përpara teje, se nuk i kemi mbajtur, as i kemi bërë dot, kumandat që na dhe o Zot, po mos na dëno në Ferr dhe n' errësirë, o Perëndi i Atërve.

VIII. Zotin që e lavdërojnë Engjëjtë, me Kerubim dhe Serafim më qjell, eni të gjithë krijesat, hymnoni dhe bekoni, dhe e lartësoni përherë dhe për jetë.

IX. Qysh linde nukë merret vesh, o Zonjë o Hyjlindëse, dhe qysh ke mbetur prap' e virgjër pasandaj, po lindja e Zotit na ka përsëritur shpirtet; kudo pra që

të gjithë përmi dhe, si një Nënë Perëndie, të madhështojmë besërisht.

Pas Dërgimësore Ngjallësore këndohen:

DERGIMESORET, T.II.

PAS TIS MATHETES SINELTHOMEN

Ditën e gjyqit plot me tmerr, dhe lavdi ëngjëllore, kujtonj i ziu gjithënjë, edhe dridhem nga frika, dhe të thërres i tronditur: Kur të vish përmi dhenë, për të gjykuar njerëzit, o gjykatës i shenjtë me drejtësi, mos më dëno për zjarrin e Ferrit, po më të djathtëm më vëndos, o Zot i zëmërdhëmpshur.

O Krijetar i botëve, o Zot i gjithësisë, prej Shën Marisë more trup, dhe njeri pa ndryshuar, për njerëzit na u-bëre, na përsërite shpirtin, të prishur prej mëkatave, ti që linde prej Nënë çuditërisht, pra thërresim besërisht që të gjithë, me lavdërim dhe brohori: Zonj' e jetës gëzohu.

LAVDERIMET

Këndohen pesë të Tingëllit edhe tri të Përsëmbëllta të Triodit më T.T.II:

PAS OLIN APOTHEMENI

Ja trumbeta oshëtin, të gjithë varret po hapen, ngrihen të varrosurit, dhe natyra dridhet me gjithë njerëzit; mirë-vepëronjësit, po këcejnë plot me gas, dyke pritur rogë dhe çpërblim, dhe ligjë-shkelësit, qajn' e lebetiten pa ngushëllim, në flagë shkojnë dhe në zjarr, poshtë në Skëterrën e sqyfurit: Kij për ne mëshirë,

vëndosna me të vyerit o Krisht, me shoqërin' e Shënjtoreëve, ne që po të lutemi.

Qanj edhe vajtonj me lot, kur më kujtohet Skëterra, Ferri i demonëve, zjarri dhe kazani plot me katran të zi, dhe me tym prej sqyfuri, drithtërim' i koskave, kërcëllim' i keq i dhëmbëve, dhëmbjet e hidhura, vuajtjet pa funt të fajtorëve, që ndesnë zëmërimin tënt, me paudhësi dhe me prapësi: Kij për ne mëshirë, vëndosna me të vyerit o Krisht, me shoqërin' e Shënjtoreëve, ne që po të lutemi.

Librat hapen faqeza, edhe zbulohen të fshehtat, veprat e fajtorëve, gjithë të këqiat e mëkatarëve; fush' e tërë tej përtej, gumëzhit plot me tmerr, me vajtim edhe me psherëtim, se të dënuarit, hidhen në mundime që s' kanë funt, në zjarrin dhe në sqyfurin, dhe në kërcëllimin e dhëmbëve: Kij për ne mëshirë, vëndosna më të vyerit o Krisht, me shoqërin' e Shenjtoreëve, ne që po të lutemi.

LAVDI, T.I.

Le ta paqësojmë veten o vëllezër, për mbretëreshën e virtutave, se ja ku ardhi dhe na siell, pasurira dhe të mira, se ajo i zbut pasionet e egëra, dhe i pajton fajtorët me Perëndinë. Pra le ta presim me gëzim, edhe le t'i thërresim Krishtit: O Zot, që u-ngjalle së vdekuresh, ruajna të padënuar, ne që të lavdërojmë o i vetëmi i pamëkatmë.

Doksollogjia e Madhe. Në Hyrjen këndohet Përlëshorja e Tingëllit, e Shenjtit të Kishës, pastaj:

SHKURTORJA, T. I.

PAS TON TAFON SU SOTIR

Ku vjen o Perëndi, me lavdi përmi dhenë, kur dridhen gjithë tok, dhe një lumë prej zjarri, përpara fronit tënt po rjeth, edhe librat e veprave, hapen faqeza, edhe të fshehtat botohen, ti shpëto-m' o Zot, dhe më vëndos më të djathtë, gjykatës me drejtësi.

APOSTULLI

Zoti ynë është i math, edhe ka forcë të madhe.

Lavdërojeni Zotin, se është i mirë.

Këndimi prej Letrës I së Palit për Korinthianët.

Vëllezër, e ngrena nukë na shpie përpara Pernëdisë, se nukë tepërojmë, kur hamë, edhe kur nukë hamë, nukë shtero kemi. Shikoni pra mos kjo fuqia juaj bëhet një ndalim për të pafuqishmët. Se në të paftë të shtruar në idhulloren ty, që ke kupëtim, një njeri me ndërgjegje të pafuqishme, vallë nukë do të shtyhet ky për të ngrënë theroret e idhullave? Dhe kur mëkatoni kështu përpara vëllezërve, dhe kur e goditni ndërgjegjen e tyre të pafuqishme, mëkatoni përpara Krishit. Përandaj, nëqoftëse e ngrena e skandalizon tim-vëlla, nukë do të ha mish askurrë, që të mos e skandalizonj. Vallë nukë jam Apostull? Vallë nukë jam i lirë? Vallë nuk e pashë Zotin Jesu Krisht? Vallë nukë jini veprat e mia më Zotin? Në mos jam Apostull për të tjerët, po për ju jam. Se shila e apostullatës sime jini ju më Zotin.

UNGJILLI PAS MATTHEUT

Zoti tha: Kur të vinjë i Biri i njeriut me lavdi me

gjithë Engjëjtë, ahere do të rrinjë mi fronin e lavdisë. Dhe do të mblidhen të gjithë kombet përpara ati, edhe do t'i ndanjë njerin nga tjatri, siç i ndan bariu dhëntë nga dhitë, dhe do t'i vërë dhëntë më të djathtë, dhe dhitë më të mëngjër. Ahere Mbreti do tu thotë atyre më të djathtë: "Ejani, ju të bekuarit e tim-Ati, trashëgojeni mbretërinë, e cila u-gatit për ju që prej nisjes së botës. Se pata uri, dhe më dhatë të ha; pata etje, dhe më dhatë të pi; isha i huaj, dhe më përmblothtë; isha i çveshur, dhe më veshtë; isha i sëmure, dhe më vizituar; isha në burk, dhe arthtë tek unë." Ahere do t'i përgjigjen të drejtët, edhe do t'i thonë. "Zot, kur të pamë të urët, edhe të ushqyem; a me etje, dhe të vaditëm; dhe kur të pamë të huaj, dhe të përmblohtmë; a të çveshur dhe të veshmë; dhe kur të pamë të sëmure a në burk, dhe të vizituam?" Edhe Mbreti do tu përgjigjet, edhe do tu thotë: "Me të vërtetë po ju them: Atë që ia kini bërë njerit prej këtyre vëllezërve të mi më të vegjel, ma kini bërë mua." Pastaj do tu thotë atyre më të mëngjër: "Shkoni, ju të mallkuar lark meje në zjarrin e ameshuar, i cili u-gatit për djallin dhe ëngjëjtë e tij. Se pata uri, dhe nukë më dhatë të ha; pata etje, dhe nukë më dhatë të pi; isha i huaj, dhe nukë më përmblothtë; isha i çveshur, dhe nukë më veshtë; isha i sëmure dhe në burk, dhe nukë më vizituar." Ahere do t'i përgjigjen edhe ata, dhe do t'i thone: "Zot, kur të pamë të urët, a me etje, a të huaj, a të çveshur, a të sëmure, a në burk, dhe nukë të shërbyem?" Ahere do tu përgjigjet, edhe do tu thotë: "Me të vërtetë po ju them. Atë, që nukë ia kini bërë njerit prej këtyre më të vegjëlve, nukë ma kini bërë as mua." Edhe këta do të shkojnë në Ferrin e ameshuar, edhe të drejtët në jetën e ameshuar.

Pastaj vazhdon Mesha e Shën Joan Gojartit.